

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës; nenin 61, nenin 71, nenin 85, nenin 108, nenin 109 dhe nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; si dhe nenin 4, nenin 93, nenin 94 dhe nenin 102 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 korrik 2023, miratoi këtë:

UDHËZIM PËR KRITERET PËR EMËRIMIN E ADMINISTRATORËVE DHE LIKUIDATORËVE TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i kriterëve për emërimin e administratorëve dhe likuidatorëve të institucioneve financiare nga ana e BQK-së, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për institucionet financiare.
2. Ky Udhëzim aplikohet për të gjitha institucionet financiare për të cilat BQK-ja sipas legjislacionit përkatës në fuqi ka përgjegjësi të bëjë emërimin e administratorëve zyrtarë / të përkohshëm dhe/ose likuidatorëve gjatë procesit të likuidimit të detyrueshëm.

Neni 2

Definicionet

1. Të gjitha termet në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet, ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij Udhëzimi:
 - 1.1. **Administrator** – nënkupton personin e emëruar nga BQK-ja si administrator zyrtar/i përkohshëm, për të menaxhuar institucionin financiar gjatë procesit të administrimit zyrtar/të përkohshëm.
 - 1.2. **Likuidator** – nënkupton personin e emëruar nga BQK-ja për të menaxhuar institucionin financiar gjatë procesit të likuidimit.
 - 1.3. **Institucion financiar** – nënkupton bankat, siguresit, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare, ndërmjetësuesit në sigurime si dhe trajtuesit e dëmeve.
 - 1.4. **BQK** – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
 - 1.5. **IMF** – nënkupton institucionet mikrofinanciare.
 - 1.6. **IFJB** – nënkupton institucionet financiare jobankare.

Neni 3

Shkaqet për caktimin e administratorit të institucionit financiar

1. BQK-ja mund të emërojë një administrator për një bankë, institucion mikrofinanciar apo institucion financiar jobankar, kur përmbushen kushtet e përcaktuara sipas nenit 60 dhe nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
2. BQK-ja mund të emërojë një administrator për një sigurues, ndërmjetësues në sigurime apo trajtues të dëmeve kur përmbushen kushtet e përcaktuara sipas nenit 93 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet.
3. Vendimi i BQK-së për emërimin e administratorit duhet të specifikojë arsyet sipas të cilave është marrë.

Neni 4

Kriteret për emërimin e administratorëve për banka

1. Administratori i bankës emërohet nga BQK-ja për një mandat që nuk tejkalon gjashtë (6) muaj, siç specifikohet në vendimin e BQK-së. Mandati i emërimit mund të vazhdohet nga BQK-ja vetëm dy herë, për një periudhë që nuk tejkalon, në secilin rast, tre muaj. Nëse administratori nuk i ka zgjidhur çështjet për të cilat është emëruar t'i zgjidhë pas një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve, atëherë do të fillojë procesi i likuidimit të detyruar të bankës.
2. Çdo administrator i bankës duhet të ketë njohuri, aftësi dhe përvojë të duhur për të menaxhuar bankën, i cili i plotëson kriteret e përcaktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimin, përvojën dhe integritetin. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për t'u emëruar administrator, bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - 2.1. të ketë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: banka dhe financa, ekonomi, jurisprudencë, kontabilitet, auditim, administrim biznesi, rregullim financiar apo drejtime tjera që mund të konsiderohen të rëndësishme për sektorin financiar;
 - 2.2. të ketë përvojën prej së paku shtatë (7) viteve në fushën bankare dhe/ose financiare, nga të cilat së paku tri (3) vite në funksion menaxherial ose jo më pak se dhjetë (10) vite përvojë profesionale në fushën bankare dhe/ose financiare përkatëse, relevante për ushtrimin e pozitës së administratorit;
 - 2.3. historia personale e administratorit duhet të dëshmojë se ajo/ai është plotësisht e/i pavarur dhe se posedon kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për të kryer detyrat e saj/tij;
 - 2.4. administratori duhet të dëshmojë përmbushjen në kohë të obligimeve financiare;
 - 2.5. administratori duhet të jetë i aftë të demonstrojë se aktualisht nuk ka ndonjë konflikt të perceptuar apo aktual të interesit ndërmjet rolit të tij si administrator i institucionit financiar dhe ndonjë roli biznesor apo personal që ai bart. Kjo kërkesë duhet të përmbushet përgjatë gjithë kohës si administrator i institucionit financiar.
3. Pavarësisht kërkesave të nënparagrafëve 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të këtij neni, personat me kualifikim profesional auditor ligjor, auditor i certifikuar, kontabilist i certifikuar dhe kualifikime të tjera të barasvlershme mund të kualifikohen si administratorë të bankave, me kusht që të kenë përvojë pune së paku 7 vite në auditimin e bankave ose përgatitjen e pasqyrave financiare të bankave.

4. Administratori i bankës do të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e tij sipas përcaktimeve në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Neni 5

Kriteret për emërimin e administratorëve për IMF-të dhe IFJB-të

1. Administratori i IMF-së ose IFJB-së emërohet nga BQK-ja për një mandat që nuk tejkalon gjashtë (6) muaj, siç specifikohet në vendimin e BQK-së. Mandati i emërimit mund të vazhdohet nga BQK-ja vetëm dy herë, për një periudhë që nuk tejkalon, në secilin rast, tre muaj. Nëse administratori nuk i ka zgjidhur çështjet për të cilat është emëruar t'i zgjidhë pas një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve, atëherë do të fillojë procesi i likuidimit të detyruar të IMF-së apo IFJB-së.
2. Çdo administrator i IMF-së dhe IFJB-së duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm me reputacion të mirë, i cili i plotëson kriteret lidhur me kualifikimin, përvojën dhe integritetin. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për t'u emëruar administrator i IMF-së ose IFJB-së, bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - 2.1. të ketë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: ekonomi, financa, sigurime, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 2.2. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale në fushën financiare apo fusha tjera relevante, ose përvojë në administrimin ose likuidimin e së paku dy subjekteve juridike të madhësisë së ngjashme me IMF-në ose IFJB-në në administrim;
 - 2.3. historia personale e administratorit duhet të dëshmojë se ajo/ai është plotësisht e/i pavarur dhe se posedon kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për të kryer detyrat e saj/tij;
 - 2.4. administratori duhet të dëshmojë përmbushjen në kohë të obligimeve financiare;
 - 2.5. administratori duhet të jetë i aftë të demonstrojë se aktualisht nuk ka ndonjë konflikt të perceptuar apo aktual të interesit ndërmjet rolit të tij si administrator i institucionit financiar dhe ndonjë roli biznesor apo personal që ai bart. Kjo kërkesë duhet të përmbushet përgjatë gjithë kohës si administrator i institucionit.
3. Pavarësisht kërkesave të nënparagrafëve 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të këtij neni, personat me kualifikim profesional auditor ligjor, auditor i certifikuar, kontabilist i certifikuar dhe kualifikime të tjera të barasvlershme mund të kualifikohen si administratorë të IMF-ve ose IFJB-ve, me kusht që të kenë përvojë pune së paku 3 vite në auditimin e institucioneve financiare ose përgatitjen e pasqyrave financiare të institucioneve financiare.
4. Administratori i IMF-së dhe IFJB-së do të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e tij sipas përcaktimeve në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
5. Në rast se, sipas vlerësimeve të BQK-së procesi i administrimit nuk kryhet në mënyrë profesionale, apo administratori nuk plotëson më tutje kërkesat e mësipërme, atëherë BQK-ja mund ta shkarkojë nga pozita e administratorit.

Neni 6

Kriteret për emërimin e administratorëve për siguruesit, ndërmjetësuesit dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime

1. Administratori i siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit të dëmeve në sigurime emërohet nga BQK-ja për një mandat që nuk tejkalon gjashtë (6) muaj, siç specifikohet në vendimin e BQK-së. Mandati i emërimit mund të vazhdohet nga BQK-ja vetëm dy herë, për një periudhë që nuk tejkalon, në secilin rast, tre muaj. Nëse administratori nuk i ka zgjidhur çështjet për të cilat është emëruar t'i zgjidhur pas një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve, atëherë do të fillojë procesi i likuidimit të detyruar të siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime apo trajtuesit të dëmeve në sigurime.
2. Çdo administrator i siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit të dëmeve në sigurime duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm me reputacion të mirë, i cili i plotëson kriteret lidhur me kualifikimin, përvojën dhe integritetin. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për t'u emëruar administrator, bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - 2.1. të kenë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: ekonomi, financa, sigurime, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 2.2. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale në fushën financiare apo fusha tjera relevante, ose përvojë në likuidimin ose administrimin e së paku dy subjekteve juridike të madhësisë së ngjashme me siguruesin / ndërmjetësuesin / trajtuesin e dëmeve në likuidim;
 - 2.3. historia personale e administratorit duhet të dëshmojë se ajo/ai është plotësisht e/i pavarur dhe se posedon kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për të kryer detyrat e saj/tij;
 - 2.4. administratori duhet të dëshmojë përmbushjen me kohë të obligimeve financiare;
 - 2.5. administratori duhet të jetë i aftë të demonstrojë se aktualisht nuk ka ndonjë konflikt të perceptuar apo aktual të interesit ndërmjet rolit të tij si administrator i institucionit financiar dhe ndonjë roli biznesor apo personal që ai bart. Kjo kërkesë duhet të përmbushet përgjatë gjithë kohës si administrator i institucionit.
3. Pavarësisht kërkesave të nënparagrafëve 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të këtij neni, personat me kualifikim profesional auditor ligjor, auditor i certifikuar, kontabilist i certifikuar dhe kualifikime të tjera të barasvlershme mund të kualifikohen si administratorë të IMF-së ose IFJB-së, me kushte që të kenë përvojë pune së paku 3 vite në auditimin e institucioneve financiare ose përgatitjen e pasqyrave financiare të institucioneve financiare.
4. Administratori do të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e tij sipas përcaktimeve në Ligjin për Sigurimet dhe rregulloret përkatëse në zbatim të tij.

Neni 7

Kriteret për emërimin e likuidatorëve për bankat

1. Në rast të revokimit të licencës së një banke, BQK-ja menjëherë e emëron një likuidator përkatës.
2. Likuidatori mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së që i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 4 të këtij udhëzimi.

Neni 8

Kriteret për emërimin e likuidatorëve për IMF-të dhe IFJB-të

1. Në rast të revokimit të regjistrimit të një IMF/IFJB, BQK-ja menjëherë e emëron një likuidator përkatës.
2. Likuidatori mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së që i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 5 të këtij udhëzimi.

Neni 9

Kriteret për emërimin e likuidatorëve për siguruesit dhe ndërmjetësuesit në sigurime

1. Në rast të revokimit të licencës së një siguruesi/ndërmjetësuesi në sigurime/trajtuesi të dëmeve në sigurime, BQK-ja menjëherë e emëron një likuidator përkatës.
2. Likuidatori mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së, që i plotëson kriteret përcaktuara me Rregulloren për Likuidimin e Siguruesve.
3. Përveç kriterëve të përcaktuara me Rregulloren për Likuidimin e Siguruesve, janë të aplikueshme edhe kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim për atë që nuk janë në kundërshtim me Rregulloren për Likuidimin e Siguruesve.

Neni 10

Kriteret përjashtuese për emërimin e administratorëve dhe likuidatorëve të institucioneve financiare

1. Një person nuk mund të emërohet si administrator apo likuidator i një institucioni financiar, nëse ai person:
 - 1.1. është i dënuar për krime ose është gjetur fajtor për vepra penale ekonomike sipas Kodit Penal;
 - 1.2. është larguar nga posti në një institucionin financiar nga BQK-ja;
 - 1.3. është dënuar nga një gjykatë penale për vepër penale për të cilën personi është ose ka mundur të dënohet me burgim prej një viti a më shumë, ku nuk ka ekzistuar opsioni i gjobës;
 - 1.4. ka qenë debitor në një procedurë falimentimi ose paaftësie paguese brenda dhjetë (10) viteve të fundit;
 - 1.5. është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit për shkak të sjelljes së pahijshme personale, ushtrimit joprofesional të detyrave ose të abuzimit të pozitës zyrtare;
 - 1.6. ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një institucioni financiar licenca/regjistrimi i së cilës është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruar tjetër jovullnetar i së cilës është iniciuar gjatë mandatit të atij drejtori ose menaxheri të lartë;
 - 1.7. ka konflikt interesi dhe është person i ndërlidhur me institucionin financiar në të cilin synohet të emërohet;
 - 1.8. ka qenë auditor i jashtëm i institucionit financiar përkatës gjatë vitit të fundit nga koha e vendosjes së institucionit nën administrim ose likuidim;
 - 1.9. ka kërkesa/pretendime ndaj institucionit financiar përkatës; dhe

1.10. ka qenë i angazhuar si ekzaminer i BQK-së, në atë institucion financiar, në çfarëdo kohe gjatë gjashtë (6) muajve para vendosjes së institucionit nën administrim ose likuidim.

Neni 11

Shkarkimi i administratorëve dhe likuidatorëve të institucioneve financiare

1. BQK-ja mund ta përfundojë mandatin e administratorëve dhe/ose likuidatorëve për arsyt si në vijim:
 - 1.1. nëse administratori dhe/ose likuidatori nuk vazhdon më tutje t'i plotësojë kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim;
 - 1.2. nëse administratori dhe/ose likuidatori emërohet si administrator ose likuidator në një institucion tjetër financiar;
 - 1.3. nëse administratori dhe/ose likuidatori kryen aktivitetin e administrimit ose likuidimit në mënyrë joprofesionale, jo në mirëbesim ose nuk është në gjendje të kryejë aktivitetet e tij;
 - 1.4. nëse administratori dhe/ose likuidatori paraqet dorëheqje (me shkrim).
2. Në rastet e ndryshimit të administratorit ose likuidatorit, administratori ose likuidatori i shkarkuar/dorëhequr duhet të vazhdojë punën deri në emërimin e administratorit ose likuidatorit të ri, përpos nëse kërkohet ndryshe nga BQK-ja.

Neni 12

Lista e administratorëve dhe/ose likuidatorëve

1. BQK-ja, përmes thirrjes publike, do t'i ftojë të gjithë të interesuarit që i plotësojnë kriteret për t'u emëruar si administrator ose likuidator në pajtim me dispozitat e këtij udhëzimi, të aplikojnë për administrator dhe likuidator të institucioneve financiare.
2. Gjatë vlerësimit të saj, BQK-ja mund të kërkojë të intervistojë administratorin ose likuidatorin potencial.
3. Pas vlerësimit të përmbushjes së kriterëve nga ky udhëzim, BQK-ja do ta përpilojë listën e personave të kualifikuar për administrator dhe likuidator.
4. BQK-ja mund të emërojë administratorin dhe/ose likuidatorin nga lista e personave të kualifikuar për administrator dhe/ose likuidator, apo ndonjë person edhe jashtë kësaj liste, me kusht që i njëjti nuk mund të përzgjidhet nga lista.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi më datën 1 gusht 2023.



Bashkim Nurboja

Kryesues i Bordit Ekzekutiv